



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 44/ 2011

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani kryesues, Rafet Haxhaj dhe Hasan Shala, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të parregullsive gjatë procesit të votimit, në seancën e panelit të mbajtur me 13.01.2011, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV).

A r s y e t i m

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 10.01.2011, nga subjekti politik LVV, ne te cilën pretendohet se “me datë 09.01.2011, në fshatin Turiqevc komuna e Skenderajt, në QV 2117b vëzhguesit e LVV, Arbënor Dehari, Besart Abazi, Azem Kelmendi dhe Tahir Rrustemi janë kërcënuar tejet seriozisht nga persona të panjohur jozyrtar; vëzhguesit kane vendosur te tërhiqen ne orën 17:30 për shkak te parregullsive të panumërta, mirëpo janë detyruar qe pa dëshirën dhe vullnetin e tyre të jenë prezent deri në përfundim të procesit të votimit dhe numërimit të votave në këtë qendër votimi. Në vazhden e këtyre kërcënimeve nuk është ndërmarrë asnjë veprim për ti ndalur brutalitetin verbal dhe për të vendosur qetësi, edhe pas kërkesave të vazhdueshme të vëzhguesve, personave zyrtar të kësaj qendre të votimit dhe KKZ-se në Skenderaj. Shtabi zgjedhor e ka denoncuar këtë rast në stacionin policor”.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3 paragrafi 6 pika (c) parasheh si vijon:

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

- **ankesa është e pabazuar.**

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës janë të pabazuara për shkakun nuk janë ofruar prova të mjaftueshme për shkeljen e pretenduar. PZAP vlerëson se nuk është bërë identifikimi i personave të cilët i kanë kërcënuar vëzhguesit e LVV-se, pasi që identiteti i personave që kanë kërcënuar është i panjohur edhe për vet ankuesin.

Njëkohësisht PZAP vlerëson se në përputhje me nenin 118.4 mund të rishikojë cilindo nga vendimet e mara pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuara më lartë e po ashtu në pajtim më dispozitat e cituara ligjore si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 44/2011 më datën 13.01.2011.

**Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani**

